

VENDIM
Nr. 643, datë 27.8.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN NË ZONËN E TREGUT TË HAPUR TË QYTETIT TË VLORËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban në zonën e tregut të hapur të qytetit të Vlorës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 650 040 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e dyzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 650 040 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e dyzet) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Bashkia Vlorë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, e cila brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE
TË TË CILËVE, SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN NË ZONËN E TREGUT TË HAPUR TË
QYTETIT TË VLORËS”**

Numër rendor	Pronari	Të dhënat kadastrale (Sipas kartelës së pasurisë)								Vlerësimet për shpronësim			Vlera totale (lekë)	Shënime
										Truall				
		Emër/ mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)		
1	Latif Aqif Xhyheri, Ruzhdi Xhyheri, Selaudin Xhyheri, Shermin Aqif Leskoviku, Shpetime Aqif Bazaj, Shazime Aqif Angoni	8605	53/75	Truall	210	210		17	176	198.8	8300	1,650,040	1,650,040	
	Vlera totale												1,650,040	